



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 76/12
Prishtinë, më 29.08.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Duda Balje, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa.

Munguan: Naser Osmani dhe Albana Fetoshi.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Kushtrim Aliu dhe Albulena Gashi (praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ismet Krasniqi Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Komisionit Evropian, KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuajorin e vitit 2012;**
- 3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së dytë të Ministrisë së Financave 2013/02;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Shqyrtimi i Raportit të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuajorin e vitit 2012

Kryetarja theksoi se raporti është i përgaditur dhe ka mundësi të shifen të gjitha shpenzimet në mënyrë të detalizuar dhe se përqindja e buxheti është shpenzuar 68%. Ndërkaq ajo qfarë është problematike, që po vazhdon edhe tani, janë realizimi i ultë i shpenzimeve kapitale.

Ismet Krasniqi njoftoi se shpenzimet për gjashtëmuajorin e këtij viti, në total janë 45% dhe në vazhdim prezantoi shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Është një dukuri që investimet kapitale në të gjitha

institucionet e shënon një trend të tillë të realizimit në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për shkak të procedurave të prokurimit. Në investimet kapitale nuk mund të anashkalohej çështja e projektit Villa Gërmija, një investim i cili po hyn në vitin e shtatë pa asnjë lëvizje në këtë drejtim. Vendosija për këtë projekt i tejkalon kompetencat e administratës dhe është vendim politik e kisha lut këtë komision që ta sensibilizoj këtë çështje. Nëse i krahasojmë realizimin e shpenzimeve me Presidencën apo Zyrën e Kryeministrit shohim se Kuvendi qëndron më mirë në realizimin e shpenzimeve në këtë periudhë raportimit dhe është afër me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Hasime Krasniqi e përgëzoi sekretarin me stafin e tij për hartimin e një raporti të detalizuar. Megjithatë kam një vërejtje me titullin e raportit gjashtëmujor, i cili në fakt i cili nuk i përfshin të gjitha shpenzimet për gjashtë mujorin siq është rasti i pagave të qershorit që nuk janë paraqitur në raport, ndërkaq disa shpenzime të kategorive tjera të ndodhura në këtë muaj janë paraqitur dhe kisha dashur një sqarim për këto çështje?

Istret Azemi sa i përket çështjes së mospërfshirjes së pagave të qershorit në këtë raport, nuk janë prezantuar sepse pagat e qershorit dalin në korrik dhe raportohen si shpenzime në këtë muaj, kështu ndodh për secilin muaj deri në muajin dhjetor, kur e kemi pagesën e dy rrogave, rrogën e nëntorit dhe rrogën e muajit dhjetor dhe kjo praktikë është e njëjtë për të gjitha organizatat buxhetore.

Sali Asllanaj theksoi se sa i përket projektit Villa Gërmija duhet të bëhet një zgjidhje dhe të përfundohet si projekt. Ndoshta duhet shikuar edhe variantin e realizimit të projektit nga tri institucionet, Kuvendi, Qeveria dhe Presidenca. Kjo çështje duhet seriozisht të trajtohet dhe të merret vendimi politik në Kuvend.

Kryetarja rikujtoi se pothuajse në qdo rekomandim që iu kemi drejtuar Kryesisë me rastin e shqyrtimit të raporteve periodike e kemi ngrit çështjen e projektit “Villa Gërmija” dhe kemi kërkuar të gjindet zgjidhja dhe të merret një vendim. Meqë zgjidhja e këtij problemi kërkon marrjen e një vendimi politik që duhet të merr Kryesia apo Kuvendi, kjo i tejkalon kompetencat e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ne e kemi pasur raportin e detalizuar të përgaditur nga administrata lidhur me këtë projekt dhe ne mund të diskutojmë më në detale dhe ta ngrisim si çështje që të debatohet në Kuvend.

Latif Gashi theksoi se nga ajo se si ka rrjedhur puna me këtë projekt, shifet se nuk po ka vullnet politik që të zgjidhet problemi me këtë projekt. Njëra ndër arsyt është edhe se projekti është në kontest gjyqësor. Mendojë që sekretari do të duhej që të sugjeroj Kryetarin e Kuvendit, që në një mbledhje të Kryesisë dhe shefave të grupeve parlamentare të debatohet kjo çështje. Meqë kërkohet të merret një vendim politik për të zgjidhur problemin e këtij projekt, vlerësoj se ne si Komision nuk kemi kompetenca të debatojmë për atë.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmujorin e vitit 2012.

3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së dytë të Ministrisë së Financave 2013/02

Kryetarja theksoi se ne i ke i shqyrtuar kërkesat buxhetore të Kuvendit sipas qarkores së parë dhe do të doja nga sekretari të na sqarojë se a ka shumë ndryshime të këtyre kërkesave nga ato të mëparshme që janë mbështetur nga komisioni. Tani është faza edhe dëgjimeve buxhetore në Ministrinë e Financave dhe ne

mbledhjen e kaluar kemi vendosur që dy anëtar të marrin pjesë në kohën kur do të diskutohet buxheti i Kuvendit.

Ismet Krasniqi njoftoi se kufijtë e kërkesave buxhetore të qarkores së dytë janë të ngjashme me ato të qarkores së parë. Dallimi në mes kërkesave buxhetore për vitin 2013 dhe buxhetit të Kuvendi pas rishikimit të buxhetit është rreth 142.000 euro. Në vazhdim prezantoi kërkesat sipas kategorive ekonomike. Po ashtu theksoi se nëse Ligji për Pagat e shërbyesve civil fillon të implementohet ne i kemi kalkuluar shumën e mjeteve që nevojitet që janë jashtë kërkesave të prezantuar, pasi që është një konstatim se do të mbulohen nga fondi i qeverisë i ndarë për këtë qëllim.

Sali Asllanaj pa i dhënë ngjyrimë politike çështjes, mendojë që buxhetin e Kuvendit duhet ta përgatit dhe përgatit vetë Kuvendi dhe Qeveria të mos ketë të drejtë të ndërhyjë, përveç se ashtu siç është përgaditur buxheti nga Kuvendit të bëhet pjesë e buxhetit të Kosovës. Normalisht që Kuvendit duhet të përfill të gjitha procedurat në përgatitjen e buxhetit vjetor, dhe Qeveria apo Ministria e Financave mundet me dhënë ndonjë propozim por edhe jo të ndikojë apo ndërhyjë në buxhetin e Kuvendit.

Kryetarja një sqarim për këtë çështje, e kemi ligjin për menaxhimin e financave publike që parasheh procedurën e përgatitjes së buxhetit për të gjitha organizatat buxhetore. Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguar të marrin pjesë në dëgjimet buxhetore dhe të dërgojnë kërkesat në Ministrinë e Financave. E njëjta procedurë aplikohet edhe për institucionet e pavarura, të cilat gjithashtu mund të dorëzojnë kërkesat buxhetore edhe në Kuvend. Kjo vlen edhe për Kuvendin që është organizatë buxhetore, që duhet të dorëzojë kërkesat në Ministri dhe të merr pjesë në dëgjimet buxhetore dhe të arsyetojë kërkesat. Në fund Kuvendi është ai që merr vendimin përfundimtar për Ligjin e buxhetit.

Latif Gashi duke i ditur procedurat e buxhetit, unë mendoj që ne nuk duhet të shkojmë vetëm për buxhetin e Kuvendit dhe të bëhemi avokat i Kuvendit. Është në rregull nëse marrim pjesë në këto dëgjime edhe për organizatat tjera buxhetore por jo vetëm për Kuvendin.

Sali Asllanaj ideja ime ishte që organi ligjvënës nuk duhet të i jap llogari qeverisë, përkundrazi duhet të ndodh e kundërta. Mendimi im është që ne duhet të përgatisim buxhetin dhe t'ia dorëzojmë Qeverisë për përfshirje në buxhetin e Kosovës pa patur të drejtë në ndërhyrje.

Kryetarja theksoi se ne duhet të respektojmë legjislacion dhe procedurat ligjore që janë në fuqi, sa i përket përgaditjes dhe vendosjes për buxhetin e institucioneve dhe agjencioneve të pavarura. Një praktikë e tillë aplikohet edhe në vendet tjera. Madje ne jemi dëshmitar nga vizita në Gjermani, se Ministria e Financave është përgjegjëse në përgatitjen e buxhetit për të gjitha organizatat buxhetore dhe Kuvendi, përmes Komisionit për Buxhet është autoriteti i fundit që vendos. Sa i përket pjesëmarrjes së anëtarëve të Komisionit në dëgjimet buxhetore, roli i këtyre anëtarëve më tepër është informues dhe nuk kemi kompetencë të ndërhyhet në këtë fazë të përgatitjes së buxhetit. Mund të japim një mendim lidhur me kërkesat e organizatave buxhetore. Ne duhet të veprojmë sipas rregullatave ligjore që është në fuqi.

Ismet Krasniqi theksoi se nëse bazohemi në Rregulloren e Kuvendi, unë si sekretar nuk kam autoritet me kompetencë të prezantoj buxhetin e Kuvendit në Ministri i vetëm. Fakti është se buxhetin e Kuvendit duhet të përgatit Komisioni për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me administratën dhe miratojë Kryesia. Sipas këtij rregullin, një aftër i Kryesisë duhet të arsyetojë buxhetin në dëgjimet buxhetore. Unë si Sekretar nuk ka të drejtë të pajtohem me asnjë ndryshim, që propozohet nga Ministria e Financave me atë që ka vendos Kryesia.

Hykmete Bajrami administrata ekziston për deputetët. Mendojë që ne si deputetë duhet të paraqesim kërkesat dhe nevojat tona dhe jo administrata. Jam plotësisht e pajtimit që grupet parlamentare dhe

Komisioni për Buxhet dhe Financa të caktojnë buxhetin, duke ditur nevojat për udhëtimet zyrtare apo vizitat studimore. Kemi pasur rastin e mungesës së kompjuterëve për deputetë, apo mungesa e zyreve për deputetë, apo edhe rasti i djeshëm për projektligjin për metrologji që e miratojmë me implikime buxhetore dhe më pas ligji nuk mund të implementohet dhe marrim vërejtje në raportin e progresit. Pjesëmarrje në dëgjimet buxhetore është vetëm formale dhe sa për informim. Të gjithë e dijme që kërkesat buxhetore nuk mund të vendosim në Komision pa marrë dritën e gjelbërt prej Ministrisë së Financave se a ka buxhet.

Kryetarja theksoi se Kryesia e Kuvendit bazohet në atë që përgatit administrata. Arsyeshmërin duhet të jep administrata. Mungesa e zyreve për deputetë nuk është pasojë e mungesës së mjeteve buxhetore. Sa i përket projektligjit të djeshëm erdhëm në përfundim se dispozitat e tij nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Në të ardhmen në përgatitjen e buxhetit të Kuvendit ne mundemi paraprakisht të bisedojmë dhe të prezantojmë kërkesat dhe nevojat tona para se ato të finalizohen si të shkruara. Mirëpo për të bërë këtë duhet ti kemi politikat e shkruara dhe të miratuar nga Kryesia e Kuvendit, psh. për investimet kapitale dhe shpenzimet tjera.

Muhamet Mustafa mendoi që ajo qfarë është shkruar në Rregulloren e Kuvendit për përgatitjen e buxhetit duhet të ndryshohet sepse do të paraqiste konflikt interesi që Komisioni për Buxhet dhe Financa të përgatitje buxhetin, ku ndër të tjera janë edhe pagat dhe shpenzimet tjera për nevojat si deputetë që jemi. Sekretari do të duhej të dorëzoi buxhetin në Ministrinë e Financave, e se si Komision duhet të trajtojmë sikurse të gjitha organizatat buxhetore, kur do ta shqyrtojmë buxhetin vjetor.

Xhevdet Neziraj theksoi se esenca e dëgjimeve buxhetore kanë për qëllim që të dëgjojmë arsyeshmërin e kërkesave buxhetore. Kjo është shumë e nevojshme për punën e komisionit me rastin e shqyrtimit të kërkesave buxhetore të agjencioneve buxhetore, pasi siq e dijme të gjithë kërkesat na vijnë jo të hartuara dhe arsyetuara mirë. Këto agjencione kërkojnë mjete shesë dhe nuk janë gjendje të arsyetojë siq duhet ato kërkesa. Ndërkaq përkrahu mendimin e profesorit që Kuvendi të ketë kushte më të mira, por se duhet respektuar procedurat ligjore në përgatitjen e buxhetit.

Latif Gashi theksoi se Kuvendi është organizatë buxhetore si të gjitha organizatat tjera dhe duhet të përfillej procedurat ligjore në përgatitjen e buxhetit. Çështja e përgatitjes së buxhetit nuk të përzihet çështje e kompetencave të mbikëqyerjes së institucioneve.

Pas diskutimeve, Komisioni me Nëntë vota Për (Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Duda Balje, Xhevdet Neziraj dhe Muhamet Mustafa), një Abstenim (Sali Asllanaj) dhe asnjë Kundër, nxori këtë

REKOMANDIM

- I. Kryesia e Kuvendit të miratojë kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013, dhe t'i rekomandojë Ministrisë së Financave që të njëjtat t'i përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj

